



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 2812/1 prot

Elbasan, më 06.11.2024

VENDIM
Nr 56, datë 06.11.2024

Për
shprehjen e vullnetit për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së qiradhënies të lidhur
me subjektin tregtar, "Person Fizik: Gazmend Hodaj".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 6 datë 10.02.2024 "Për dhënie me qira ambientet e UE-së", Kontratës me nr. 358/3 prot., datë 16.02.2024 "Për dhënie me qira të mjediseve në Korpusin kryesor të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'" me subjektin tregtar, "Person Fizik: Gazmend Hodaj", Vendim i Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasani nr. 768 Vendimi, datë 05.11.2024 "Shkurtim Vendimi Për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Të miratojë shprehjen e vullnetit për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së qiradhënies nr. 358/3 prot., datë 16.02.2024 "Për dhënie me qira të mjediseve në Korpusin kryesor të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'" e lidhur me subjektin tregtar, "Person Fizik: Gazmend Hodaj", bazuar në Vendim i Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasani nr. 768 Vendimi, datë 05.11.2024 "Shkurtim Vendimi Për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit". Ky vendim vjen si pasojë e konstatimit të shkeljes së nenit 2, nenit 6 dhe nenit 10 të kontratës së qirasë.
- 2- Ndërprerja e kontratës së qirasë duhet të realizohet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të negocimit me subjektin tregtar "Person Fizik: Gazmend Hodaj".
- 3- Me subjektin tregtar "Person Fizik: Gazmend Hodaj", të negociohet për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së qirasë. Afati i negocimit fillon nga dita e marrjes së njoftimit të këtij vendimi dhe shtrihet nga kjo datë për 5 ditë kalendarike. Pas kalimit të afatit 5 ditor

kalendariq të negocimit, mjediset e dhëna me qira, të rikthehen në gjendje të lirë në funksion të institucionit, brenda 30 ditëve kalendarike.

- 4- Pagesa e qirasë për mjediset e marra nga subjekti, ndërpritet pas përfundimit të afatit kohor të negocimit dhe nuk vazhdon më tej.
- 5- Ngarkohet Administratori i Universitetit për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore, lidhur me këtë vendim .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi

